



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:151877
Datë: 29.02.2024
Numri i dokumentit: 05392639

Ac.nr.2432/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B. M. nga Ferizaj, H. B. nga fshati C. Komuna Shtime, Xh. K. nga Ferizaj, A. H. nga Ferizaj dhe S. N. nga fshati D Komuna Ferizaj, të cilët i përfaqëson me autorizim D. H., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore nga Ministria e Drejtësisë, me përfaqësuesin me avokatin shtetëror M. K. nga Prishtina, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.2021:151878, të datës 10.03.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.2021:151878, i datës 10.03.2022, në pikën I, IV dhe V, VËRTETOHET.

II. Pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.2021:151878, të datës 10.03.2022, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.2021:151878, të datës 10.03.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B. M. nga Ferizaj, H. B. nga fshati C. Komuna Shtime, Xh. K. nga Ferizaj, A. H. nga Ferizaj dhe S. N. nga fshati Doganaj Komuna Ferizaj, ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policës së Kosovës, që në emër të kompensimit të pagës së 13-të (trembëdhjetë), në lartësi të një page mujore dhe atë për vitet

2018, 2019, 2020 dhe 2021, të u paguajë shumat si vijojnë: Padiësit; B. M., të i paguaj shumën prej 2,428.68€ (dy mijë e katërqind e njëzetë e tetë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent); Padiësit; H. B., të i paguaj shumën prej 2,771.68€ (dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një euro e gjashtëdhjetë e tetë cent); Padiësit; Xh. K., të i paguaj shumën prej 2,460.04€ (dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë euro e dyzetë cent); Padiësit; A. H., të i paguaj shumën prej 1,762.74€ (një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e katër cent) dhe; Padiësit; S. N., të i paguaj shumën prej 2,276.60€ (dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë cent); Të gjitha këto secilit padiës veç e veç me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë (12.07.2021) deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm. II .REFUZOHET pjesa tjetër e lartësisë së kërkesëpadisë së padiësit A. H., përtej asaj që është aprovuar në pikën I me numër 5) të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilën ka kërkuar që në emër të një page mujore për vitin 2018, të i kompensohet paga e trembëdhjetë në lartësi prej 587.58€ (pesëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, si e pabazuar. III.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë e padiësëve, me të cilën kanë kërkuar që e paditura të Obligohet që të u kompensojë shujtën ditore në lartësi prej 3,50€, dhe atë; padiësit B.M. për 783 ditë pune shumën prej 2,740.50€, H. B. për 776 ditë pune shumën prej 2,716.00€, Xh. K. për 869 ditë pune shumën prej 3,041.00€, A. H. për 877 ditë pune shumën prej 3,069.50€ dhe S. N. për 642 ditë pune shumën prej 2,247.00€, me kamatë ligjore prej 8%, si e pabazuar. IV. DETYROHET e paditura që padiësve të u kompensojë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,455.00€ (një mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore-përmbarimit të detyrueshëm. V. OBLIGOHEN padiësit që në mënyrë solidare të paguaj taksën shtesë për paraqitjen e padisë në shumë prej 80.00€(tetëdhjetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm.”

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura përmes të autorizuarit së saj, brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën e paraqitur si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta prish apo ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e padiësve si të pabazuar.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se padiësit kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se padiësit B. M. nga Ferizaj, H. B. nga fshati Carralevë Komuna Shtime, Xh. K. nga Ferizaj, A. H. dhe S. N. nga Ferizaj, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 12.07.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, të cilën e kanë precizuar përmes parashtrësës së datës 17.01.2022, për kompensimin e shpërblimit për pagë të fundvitit dhe shujtave ditore (me detaje të tjera si në petitumin e padisë). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2021:151878, të datës 10.03.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër tjera ka arsyetuar se “ nga provat e administruara shihet se paditësit dhe e paditura kanë lidhur marrëdhënie pune, gjë që për palët dhe gjykatën ky fakt nuk ka qenë asnjëherë kontestues gjatë shqyrtimit të çështjes, pasi që kjo çështje vërtetohet edhe nga vetë vërtetimet e lëshuara nga vetë e paditura, ku nga këto vërtetime vërtetohet fakti se është paditësit si zyrtarë policor janë në cilësinë e punëmarrësit ndërsa e paditura në cilësinë e punë dhënësit. Gjatë rrjedhës së procedurës dhe vlerësimit pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata gjeti se ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese se palët paditëse janë në marrëdhënie pune tek e paditura, në cilësinë e Zyrtarëve Policor. Për të paditurën gjatë gjithë procedurës nuk ishte kontestues fakti i ditëve të pranisë në punë për paditësit dhe nuk ishte kontestuese vlerësimi i performancës së paditësve për periudhën 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Ndër tjera gjykata, ka analizuar shkresat e lëndës dhe në asnjë nga shkresat e lëndës nuk ka arrij të gjejë ndonjë provë me të cilën do të provohej se paditësit kanë qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore apo nuk kanë marr vlerësimin e kënaqshëm në performancën e tyre, dhe si rezultate i të njëjtave, do të privoheshin nga e drejta për të gëzuar këtë benefit.

Më tutje ka theksuar se sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit A. H., siç është cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata të njëjtën e ka refuzuar pasi që nga shkresat e lëndës respektivisht nga formularët e vlerësimit për vitin 2018, shihet se nuk ka prova të mjaftueshme për të dëshmuar faktin se i njëjti ka marr vlerësimin vjetor për tërë vitin 2018, nga prova material shihet se i njëjti ka vlerësim vetëm për periudhën kohore nga data 03.12.2018 deri më 01.01.2019, respektivisht vetëm për 28 ditë pune të vitit 2018, andaj këtë pjesë të lartësisë së kërkesëpadisë për vitin 2018 në vlerë prej 587.58€, gjykata konform nenit 322 par.1 lidhur me nenin 319 par.1 të LPK-së, e ka refuzuar si të pabazuar në mungesë të provave. Ndërsa sa i përket vendosjes si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me anë të së cilës është refuzuar kërkesëpadia e paditësve lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe atë për periudhën 2018 deri 2021, pasi që paditësit nuk kanë arritur të provojë faktin se me të paditurën si punëdhënëse, kanë raport kontraktual ku është përcaktuar detyrimi i të paditurës që të përmbush detyrimin ndaj paditësve për pagimin e shujtave ditore.

Lidhur me bazën ligjore është bazuar në nenin 29, paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës lidhur me nenin 4, paragrafi 1, nenin 44, paragrafi 2, 55, paragrafi 1 dhe 47, paragrafi 4 të Ligjit për Policinë.

Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe për shpenzimet në bazë të nenit 452, paragrafi 3 dhe 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe të njëjtit kanë performancë të kënaqshme në punë tek e paditura, përkatësisht paditësit B. M., H. B., Xh. K., A. H. dhe S. N., sipas formularëve për vlerësim të performancës rezulton se kanë pasur performancë shumë të mirë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë e Kosovës nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45, Udhëzimit Administrativ nr.4/2017 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht të nenit 29 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13 kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar kërkesë padinë e paditësve dhe detyruar të paditurën që të njëjtëve t'ua shpërblejë (kompensojë) pagat e trembëdhjeta, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësve t'iu paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit të pagave të 13, me të drejtë është bazuar Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës konkretisht të nenit 29. Paragrafi 2, i cili përcakton të drejtën për pagën e 13 kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm. Këtë çështje e ka sqaruar edhe Gjykata Supreme e Kosovës përmes Mendimit Juridik GJ.A.nr.213/2023, datë 09.10.2023, në pikën II të tij.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili përcakton se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës ”*, ashtu që paditësit padinë e kanë parashtruar me datë 12.07.2021 dhe kërkesën e tyre e kanë paraqitur për vitet 2018 e tuje ashtu që kërkesat e të njëjtëve nuk janë parashkruar dhe të njëjtat janë paraqitur brenda afatit.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t’i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t’u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Gjykata e Apelit të Kosovës, vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi pasi që për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësve si në pikën II dhe III të aktgjykimit të ankimuar me ankesë nuk kishte pretendime ankimore nga e paditura.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së dhe me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2432/2022 datë 26.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj